



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:168834
Datë: 30.08.2024
Numri i dokumentit: 06107493

C.nr.1318/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit U. P. nga M., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Besart Kadriu, avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Qendra e Shërbimit Profesional e Shëndetit Mendor, në Mitrovicë, me objekt kontesti kompensimin e rrezikshmërisë në punë, jashtë seancës, më datë 30.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit U. P. nga M., e ushtruar kundër të paditurës Qendra e Shërbimit Profesional e Shëndetit Mendor, në Mitrovicë, me objekt kontesti kompensimin e rrezikshmërisë në punë, në këtë çështje juridike kontestimore.
- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi U. P. nga M., pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Qendra e Shërbimit Profesional e Shëndetit Mendor, në Mitrovicë, me objekt kontesti kompensimin e rrezikshmërisë në punë.

Meqënëse padia e ushtruar nuk ishte e plotë dhe e qartë, nuk përmbante atë që është paraparë me dispozitën e nenit 253 par.1, pika a) dhe d) të LPK-së, ngase në të nuk ishte precizuar saktësisht kërkesa e caktuar në pikëpamje të kërkesës kryesore dhe kërkesave eventuale aksesore si dhe vlera e kontestit, gjykata me aktvendimin e datës 11.05.2024, e ka ftuar paditësin që ta plotësojë padinë, me udhëzimet si në aktvendimin në fjalë, duke e paralajmëruar njëkohësisht edhe për pasojat e mosveprimit konform këtij aktvendimi.

Nga fletëdërgesa për dorëzim personal e cila gjendet në shkresat e lëndës rezulton se i autorizuari i paditësit, aktvendimin e lartëcekur e ka pranuar më datë 24.06.2024, mirëpo nuk ka vepruar konform tij, andaj gjykata duke u mbështetur në dispozitën e nenit 102 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë”*, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 lidhur me nenin 453 par.1 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.1318/2022 më datë 30.08.2024

G j y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.